



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 346/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Muhamet Rexha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), në Prishtinë, për shkak shënimit të grafiteve mbi posterat, në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Aleancës Kosova e Re (AKR), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3000 (tremijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 07.12.2010, ku subjekti politik (LDK) dega 5, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik AKR, se me date 6 dhjetor 2010 rreth orë 11:00 ka shkruar grafite të akronimit të saj mbi posterin e LDK-së të vendosura në objektin e shtabit zgjedhor të degës së LDK-së në fshatin Hajvali, që është në kundërshtim me nenin 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3.1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si deshmi një fotografi dhe video inçizim CD, në të cilën shihet qartë akronimi i AKR i shënuar mbi posterin e LDK-së në shtabin e saj zgjedhor. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik AKR, më datë 07.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, më datë 08.12.2010, pranoi përgjigje në ankesë nga subjekti politik AKR, në të cilën theksohet se për AKR-në një gjë e tillë është e papranueshme, pasi gjate fushatës zgjedhore subjektet e tjera politike i

frikësohen konkurrencës, në rastin konkret AKR-së. Për me tepër parashtuesi ka argumentuar se presidenti i AKR-së është prej Hajvalise, prandaj në këto raste simpatizantët e cilitdo subjekt politik “mund të kenë spreja të zi dhe të bëjnë një gje të tillë, prandaj konsiderojmë se ankesa është e pabazë, sipërfaqësore dhe e papranueshme për këtë subjekt politik”.

Përgjigjes në ankesë subjekti politik AKR nuk i ka bashkangjitur asnjë provë që tregon se ky subjekt politik ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.

PZAP-i vlerëson se subjekti politik AKR shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjatë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 346/2010 më datën 10.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

